



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 59/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Kryesuesit të VV Nuredin Hasani dhe anëtarët e VV Muharrem Çollaku, Sokol Velia, Ramadan Ramadani, Lavdim Shabani, Sofije Veliu dhe Afrim Kadriu, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), A-59 e datës 10.01.2011.

Nuredin Hasani, Kryesues i KVV nga radhët e subjektit politik PDK, Muharrem Çollaku, anëtar i KVV –së nga radhët e OJQ-së, Sokol Velia, anëtarë i subjektit politik AKR, Ramadan Ramadani, anëtarë i KVV-së nga radhët e subjektit politik LVV, Lavdim Shabani, anëtarë i KVV nga radhët e subjektit politik LDK dhe Sofije Veliu, anëtare e KVV nga radhët e subjektit politik LDD ndërsa Afrim Kadriu, nuk gjendet në listën e radhës së anëtarëve të KVV të VV me nr. 2105b-01R, në shkollën fillore “Azem Bejta” në fshatin Prekaz, iu ndaloheq që për 4 (katër) vite, të marrin pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kryesues përkatësisht si anëtarë të KVV dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor te mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, duke filluar nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

A r s e y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 10.01.2011, nga BIRN, më te cilën pretendon se Nuredin Hasani, Muharrem Çollaku, Sokol Velia, Ramadan Ramadani, Lavdim Shabani, Sofije Veliu dhe Afrim Kadriu, në cilësinë e Kryesuesit të KVV përkatësisht në cilësinë e anëtarëve të KVV me nr. 2105b-01R në shkollën fillore “Azem Bejta” në fshatin Prekaz, kanë lejuar materialin propagandistik të PDK-së në dy kabinat e këtij VV. Kjo iu është lejuar deri në ora 16:00 me këtë rast kanë bërë shkeljen e nenit 36 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi si dhe CD.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 80 paragrafi 3 LZP-së, parasheh se:

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

80.3 Kur personi, ose personat, që emërohen nga subjekti politik i certifikuar ose OJQ dështojnë në përmbushjen e obligimeve pa ndonjë arsye të fortë të saktësuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni çështje raportohet nga KKZ-ja në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Paneli Zgjedhor për ankesa dhe Parashtresa mund të shqiptoj gjobë ose sanksionim, nëse gjene se çështja është provuar.

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

120.1 Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së mund të:

120.3 d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite.

Duke vendosur PZAP ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me thyerjen e Kodit të Sjelljes së anëtarëve të KVV-ve ku emërimi i secilit anëtarë është i kushtëzuar me dhënien e betimit dhe nënshkrimin e këtij Kodi të Sjelljes siç parashihet me rregull të KQZ-së. PZAP sa i përket ndalimit për pjesëmarrje si kryesues, përkatësisht anëtarë të KVV si dhe stafit administrativ siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë se shkelja ka ndodhur nga personat të cilët kanë qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e votimit. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 59/2011 më datën 13.01.2011

